



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1223 Prot.

Tiranë, më datë 09.12.2020

VENDIM
Nr. 475 datë 09.12.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.12.2020,

VENDOSI:

1. Shtyerjen e vendimmarrjes për projektin “Ndërhyrje Konservimi dhe Përforcuese në Kullën “C” në Kalanë e Durrësit” me zhvillues "CULTURAL HERITAGE WITHOUT BORDERS-ALBANIA"
 - Plotësimi i projektit grafik me të gjitha ndërhyrjet e propozuara në relacionin teknik si: projekti i një shkallë shërbimi për ta bërë kullën më të aksesueshme; evidentimi i vlerave të kullës përmes një sistemi ndriçimi të fasadës, strukturë e përkohshme për mbrotje për mbrotje murature nga shiu, drenazhimi..etj.
 - Të firmoset projekti nga persona të licencuar në restaurim në kategoritë AP1 dhe AP2
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elva MARGARITI

SEKRETAR
Arta DOLLANI

Arta
Dollani

Digitally signed by Arta Dollani
DN: c=AL, o=Instituti
Monumenteve të Kulturës,
ou=Departamenti Përgjithshëm,
cn=Arta Dollani
Date: 2020.12.09 17:08:09
+01'00'

Elva
Margariti

Digitally signed
by Elva Margariti
Date: 2020.12.09
18:22:08 +01'00'